



---

## Protokoli i Kuvendit të katërt të rregullt të BISHZ-së më 12.01.2002

---

**Vendi:** ALFA, Zieglerstrasse 7, 4900 Langenthal  
**Data:** E shtunë, 12 janar 2002, 14.00-17.00  
**Protokoli:** Xhevat Salihu (nënkryetar), Ahmet Xhigoli (këshilltar)  
**Pjesëmarrës:** rreth. 30

---

### Pikat e rendit të ditës:

1. Përshëndetja e të pranishmëve
2. Raporti i BISHZ-së prej 09.12.2000 deri më 11.01.2002
3. Zgjedhja e Kryesisë
4. Shkarkimet
5. Ndryshimet e Statutit dhe aprovimi i tyre
6. Nënshkruesit
7. Të ndryshme

### 1. Përshëndetja e të pranishmëve

Zotëri Nazmi Jakurti i përshëndeti të gjithë të pranishmit si dhe në veçanti musafirët e fëtuar zotëri Vladimir Thanati (Ambasador shqiptar në Bernë) dhe zotëri Halim Hyda ( Sekretar i parë i Ambasadës maqedone në Bernë).

### 2. Raporti vjetor i BISHZ-së prej 09.12.2000 deri më 11.01.2002

Dokumenti "Raporti vjetor i BISHZ-së prej 09.12.2000 deri më 11.01.2002" u është shpërndarë të pranishëm.

#### Aprovimi i raportit të BISHZ-së

Zotëri Nazmi Jakurti ua lexoi raportin të pranishmëve. Pastaj është debatuar lidhur me përmbajtjen e raportit. Në diskutime morrën pjesë: zotëri Enver Pula, zotëri Imer Cacak, zotëri Vladimir Thanati, zotëri Halim Hyda, zotëri Ahmet Xhigoli, zotëri Xhevat Salihu, zotëri Sinollah Shehu. **Në përfundim të kësaj pike pas vërejtjeve të bëra për shkak të jo strukturimit të të dhënave sipas raporteve të mëparshme dhe përfshirjes së të dhënave të pa paraqitura, mungesës së pjesës financiare (bilancit), dhe mungesës së marrveshjeve me shkrim të evidentua në raport, raporti është aprovuar. Strukturimin e tij do ta bën z. Xhigoli.**



### 3. Zgjedhja e Kryesisë

Në pikën e katërt të rendit të ditës janë dhënë disa rekomandime për zgjedhje. Pas përfundimit të diskutimeve me drejtë vote është vendosur, që Kryesia e re do të jetë në përbërje prej 9 anëtarëve.

Anëtarët e rinjë të zgjedhur në Kuvend janë: dr. med. Xhevat Salihu, inxh. i dipl. Sinollah Shehu, dr.sc. Ahmet Xhigoli, Ismet Rexhaj, Jur. i dipl. Nazmi Jakurti, Imer Cacaj, dr. stom. Enver Pula, Adnan Mehmeti, Llokman Beqiri.

Njëzërit për Kryetar, Nënkyetar, Sekretar dhe Arkëtar janë zgjedhur:

- Kryetar: dr. med. Xhevat Salihu
- Nënkyetar: inxh. i dipl. Sinollah Shehu
- Sekretar: dr. sc. Ahmet Xhigoli
- Arkëtar: Ismet Rexhaj.

### 4. Shkarkimet

Në Kuvendin e sotëm personat e shënuar poshtë e kanë bërë shkarkimin:

- Zotëri Jakurti Nazmi, Nënkyetar, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë
- Zotëri Iseini Gjuliano, Anëtar dhe Sekretar, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë
- Zonja Rexhaj-Hamidi Florije, Anëtare dhe Arkëtare, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë

**Prej tash personat e përmendur lartë më nuk janë me të drejtë të nënshkrimit në emër të BISHZ-së.**

Zotëri Xhigoli në emër të Kryesisë i falendëroi 3 anëtarët e përmendur për punën e tyre të mirë.

Vërejtje: z. Nazmi Jakurti nuk i ka bërë ndryshimet e emrave të rinjë në "Handelregistër për periudhën 1999-2001.

### 5. Ndryshimet e Statutit dhe aprovimi i tyre

Në pikën e pestë të rendit të ditës është diskutuar lidhur me ndryshimet e neneve: 1.4, 16.1 dhe 16.2 të Statutit të datës 29.11.1997.

Teksti i ri i ndryshimit të neneve është përshkruar poshtë. (Po ashtu në kllapa është dhënë teksti i vjetër)

#### **Neni 1.4 .**

Selia e Shoqatës është në Bernë.

(Selia e Shoqatës është në Bernë, Fabrikstrasse 36, 3012 Bern.)

#### **Neni 16.1.**

Ky statut është miratuar nga Kuvendi i katërt i rregullt i Shoqatës, në Langenthal, në datën 12 janar 2002 dhe hyn në fuqi menjëherë.



(Ky statut është miratuar nga Kuvendi themelues i Shoqatës, në Bernë, në datën 29 nëntor 1997, dhe hyn në fuqi menjëherë.)

## Neni 16.2.

Një kopje i këtij statuti i dorëzohet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë, Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës në Prishtinë, Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në Tiranë, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Rektoratit të Universitetit të Tiranës dhe Rektoratit të Universitetit të Tetovës.

(Një kopje i këtij statuti i dorëzohet Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës në Tiranë, Ministrisë për Informim të Republikës së Kosovës në Gjenevë, Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Bernë, Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës në Prishtinë, Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë në Tiranë, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës, Rektoratit të Universitetit të Tiranës dhe Rektoratit të Universitetit të Tetovës.)

**Ndryshimet e Statutit njëzërit janë aprovuar.**

## 6. Nënshkruesit

Pas një pushimi të shkurtë është vendosur që nënshkrues në emër BISHZ-së janë personat:

- dr. med. Xhevat Sallihu, kryetar, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë.
- inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë.
- dr. sc. Ahmet Xhigoli, anëtar dhe Sekretar, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë.
- Ismet Rexhaj, anëtar dhe arkëtar, me nënshkrim kolektiv me dy anëtarë tjerë.

## 7. Të ndryshme

-

Në mbyllje të Kuvendit janë fëtuar të gjithë të pranishmit për një pije.

Udhëhqësi i protokolit: Dr. med. Xhevat Saliu  
Nënkryetar i BISHZ-së

Dr. sc. Ahmet Xhigoli  
Këshilltar i BISHZ-së